



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 984/10 prot.

Tiranë, më 30. 11 .2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 984/7, DATË 19.09.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI Z. HEKURAN KILLO”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e z. Hekuran Killo, me nr. 382 prot, datë 29.01.2021 ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjstrates L. K, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 984/7, datë 19.09.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës të paraqitur nga shtetasi z. Hekuran Killo dhe të praktikës së verifikimit të filluar me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj magjstrates znj. L. K, për dorëzim me vonesë të vendimeve të arsyetuara”, bazuar në nenin 117 dhe 122, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga e Qelqit, Lagjja Kombin, Shtëpi private Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

